



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-59021/19 dt. 13.03.2019, në emër të aplikuesve Saleh Mahd Ibrahim Albaddad, Sami Ali M Al Habaiba, Raed Mahmoud Hasan Arbasi dhe Qased Mahd Saleh Ahmad, me qëndrim të përkohshëm në Prishtinë, njëkohësisht bashkëpronarë të “Pentacle Investment and Development Company “PID””, shpk, me seli në Prishtinë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në kuadër të bllokut urban “A4” të Planit Rregullues “Prishtina e re Zona Qender”, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 930-7 dhe 930-190 ZK Matican, e cila ndodhet në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re/Zona Qender” në Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 21.03.2019 deri më 04.04.2019, në e-mail adresën: urbanizmpriштine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Kompleks me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, me etazhitet 2B +P+7-2B +P+10
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	7.00 m`
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	Në vijë ndërtimore ~ 10.90 m` ~ 21.0 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	~ 13.09 m` -21.0 m ~ 15.25 m` -30.0 m ~ 14.10 m` -28.0 m ~ 16.3 m` -30.0 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=40% ose ~ 5400 m ²
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40 % ose ~ 5400 m ²
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=3.5 dhe 3.0 ose ~ 42222m ²
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60 % ose ~ 8100 m ²
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	~ 500 vendparkime
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	/
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: